



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG
KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

R A P O R T

I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN JANAR- QERSHOR 2022

Korrik 2022

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	4-9
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE.....	10
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION.....	18
4. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	14
5. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	18
6. DREJTORIA PËR KADASTËR DHE GJEODEZI.....	28
7. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS.....	30
8. DREJTORIA PËR ARSIM.....	34
9. DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORT.....	38
10. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI.....	40
11. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI	44
12. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM.....	46
13. DREJTORIA PER PUNE DHE MIREQENIE SOCIALE.....	57
14. DREJTORIA PER SHERBIME PUBLIKE.....	59
15. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE.....	60
16. KUVENDI KOMUNAL.....	61

HYRJE

Udhëheqësi i Komunës

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/08), Statutit të Komunës si akt më i lartë i komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal dhe Komunave iu është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, përkatësisht përcaktimit të numrit të tyre. Në këtë kontekst si organe të Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari si organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe Kuvendit Komunal si organ më i lartë vendimmarrës

Kryetari i Istog-ut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale në vitin 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës mbanë 11 nga 27 ulëset në asamblenë komunale. Partia e dytë më e madhe me 7 ulëse është AAK, e përcjellur nga VV me 5 anëtarë të asamblesë, PDK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Komiteti për barazi gjinore dhe Komitete tjera siç parashihen me ligj. Komuna e publikon proces verbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 12 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim duke shtuar Zyrën e Kryetarit përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

KRYETARI I KOMUNËS

Kryetari është organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale dhe atë:

- Realizimi i projekteve prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe realizimi i projekteve të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve;
- Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale të administratës dhe kompletimi i tyre me kuadro profesionale, në këtë drejtim është angazhim permanent në organizimin dhe sistemin e shërbimit civil në atë mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuar për kryerjen e shërbimeve komunale
- Hartimi dhe propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim
- Si dhe punët dhe detyrat të tjera të rregullta nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në 6 mujorin e punës për vitin 2022 ka nënshkruar gjithësej 16 (gjashtëmbëdhjetë) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administrimit Të Pushtetit Lokal, MBPZHR-në, Kfor-in, Këshillin Evropian, Fondin Kosovar për Eficiencë të Energjisë, Organizata joqeveritare(OJQ) etj.

Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: zyra e integriteteve evropiane, zyra ligjore, zyra e komunikimit dhe informimit, zyra e menaxherit të personelit, avokati publik dhe auditori i brendshëm.

Në kuadër të zyrës së integriteteve evropiane dhe zyrës ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të zyrës së informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe media elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorateve dhe punës në përgjithësi të organeve komunale të administratës si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e Ueb faqes së komunës. Në kuadër të zyrës për menaxhimin e personelit mbahen dosjet e të gjithë shërbyesve civil dhe bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit mbi shërbimin civil dhe rregulloreve të tjera nga kjo lëmi. Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Me fillimin e mandatit si Kryetar Komune është bërë një punë mjaft e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë, identifikimi i prioriteteve të tjera, pastaj vazhdimi i prioriteteve të cilat janë realizuar e që do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorateve përkatëse. Krahas këtyre synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera: si kontaktimi me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së, EULEX-it, ICO-së, KFOR-it dhe vizitave të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, Komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë 6 muaj.

SEKTORI LIGJOR

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Për gjashtëmuajorin e parë nga data 01.01.2022 deri me 30.06.2022 ka kryer punët si me poshtë:

Për Kryetarin e Komunës- ekzekutivin janë nxjerr:

- Vendime-treqind e gjashtëdhjetë e shtatë(367);
- Kontrata-katra (4);
- Shkresa të ndryshme-gjashtëdhjetë e pesë (65);
- Autorizime-njëmbëdhjetë (11);
- Propozim-vendime dy (2)

Është punuar në grupe punuese për hartimin e rregulloreve komunale; Puna në grupe punuese për hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të ndryshme; Puna në grupin punues për funksionimin e organeve të administratës komunale; Puna për mbledhjen e të dhenave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2022 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së; Puna në komisione të ndryshme; Shpërndarja e Gazetave Zyrtare-Ligjeve në organet komunale; Bashkëpunimi-konsulltimi me Drejtoretë e Drejtorive si dhe zyrtaret komunal lidhur me zbatimin e ligjeve; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lendve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime; në trueza të rrumbullakta; në konferenca; si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi.

ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Zyra për Integritet Evropian (ZIE) ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhje me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian. Zyra në fjalë, mbikëqyrë aktivitetet e drejtorive dhe sektorëve që burojnë nga planet e Veprimit për Partneritet Evropian, obligimet e komunës që dalin nga agjenda evropiane 2022 e që ka të bëjë me Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKMSA) si dhe dokumentet tjera strategjike të MAPL-së, respektivisht Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të përgjegjësisë të Zyrës për Integritet Evropian, zyrtari përgjegjës në vazhdimësi mbikëqyrë hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar se ato janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal. Aktualisht, jemi në përgaditje të Raportit gjashtë-mujor (Jan-Qershor 2022), raport ky që pasqyron përmbushjen e obligimeve të komunës nga fusha e agjendës evropiane.

ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Zyra e auditorit të brendshëm në komunën e Istogut është i organizuar si Njësi e Auditimit të Brendshëm (NJAB) që vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit komunës me një auditor.

Aktivitetin i punës së auditorit përveç auditimit të brendshëm kryen edhe punë të tjera administrative të nevojshme për funksionimin e NJAB .

Puna e NJAB bazohet në bazë të Planit vjetor dhe strategjik që aprovohet dhe miratohet nga Kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit sipas Ligjit nr. 06/L-021 KBFP neni 23 pika 1.2 si dhe neni 25 pika 3.3 .

Gjatë periudhës gjashtëmujore është finalizuar raporti për tatimin në pronë dhe është në proces të finalizimit raportit në Drejtorinë e shëndetësisë me fushëveprim të hyrat nga participimi për shërbimet e dhëna shëndetësore dhe shpenzimet e karburantit për vitin 2021 dhe 2022 periudha janar -maj .

Raporti final i auditimit për tatimin në pronë me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna është shqyrtuar nga Komiteti i Auditimit në takimin e mbajtur në muajin mars 2022 .

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Gjatë kësaj përdhë , Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Istogut.

Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj mbi 200 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës

së Istogut në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi menaxhimin si dhe aktivitete të përditshme të komunës sonë.

Uebajti i komunës sonë pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnit të ueb faqës komunale nga ana e MAPL-së, çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës.

Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqën e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se ne ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës ku janë të publikuar rreth 367 vendime, si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje.

Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për Qasje në Dokumente Publike. Gjate periudhës Janar-Qershor janë pranuar 7 kërkesa, ku të gjithave u është lejuar qasja dhe të gjitha këto kërkesa janë përfunduar në afatin e parapare me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Avokati Publik i Komunës - Avokatura Publike Komunale funksionin e tij e ushtron në harmoni me dispozitat pozitive të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin dhe rregulloret komunale.

Puna e avokaturës publike më për së afërmi është e rregulluar me Ligjin për Avokaturën Shtetërore të Kosovës .

Për periudhën raportuese Avokatura Publike Komunale aktivitetin intensiv e kishte orjentuar në realizimin e detyrave të përcaktuara me programin e punës si dhe në krijimin e një baze qoftë edhe minimale për punë të këtij organi.

Intencë kryesore e këtij organi për periudhën raportuese ishte mbrojtja e pronës publike Një obligim i tillë është i caktuar edhe me Ligjin mbi Avokaturën Shtetërore

Detyrë tjetër e parashtruar ishte dhe ka ngelë edhe përcjellja e dukurive negative evidente posaqërisht në periudhën e pasluftës me qëllim të ndërmarrjes së masave preventive qoftë nga

ana e avokaturës publike apo me propozim për zhvillimin e procedurës administrative ose penale pran organeve kompetente.

Edhe përkundër aktivitetit të zhvilluar dhe masave të ndërmarra ka ngelë mjaft për tu bërë qoftë në munges të një baze të mirëfillt ligjore si dhe mungesës së kushteve më elementare për ushtrimin e mirëfillt të funksionit të avokatit publik, edhe se veprimet e kryera preventive dhe udhëzimet profesionale paraprahe që u janë dhënë qytetarëve i kanë dhënë edhe rezultatet e para konkrete në jetën e përditëshme .

Meqë detyrë prioritare e avokaturës publike është ndërmarrja e masave konkrete në rastet e konstatimit të paligjshmërive, keqpërdorimeve apo lëshimeve eventuale posaqërisht kur kemi të bëjmë me uzurpimin arbitrar të pronës shtetërore apo tentimit për përvetësimin e pronës shtetërore të ekspropriuar pas fillimit të punës së këtij organi vërehet një ndikim sado i vogël së paku sa i përket inicimit të procedurës gjyqësore .Numri I paditësve privat prej viti në vit po pëson rënje graduale .

Duhet cekur se puna e avokaturës publike është e drejtuar në realizimin e detyrave të parashtruara me planin operativ dhe detyrave të caktuara konkrete që lindin ad hoc(prej rastit në rastë)dhe atë brenda afatit ligjor për realizimin e tyre.Kujdes i posaqëm i është kushtuar realizimit me efikasitet dhe profesionalizëm të funksionit të besuar.

Vëllimi i punës azhuriteti dhe efikasiteti në punë

Punët-detyrat e punës të caktuara me programin e punës për periudhën raportuese e për të cilat është caktuar mbajtja e shqyrtimit në tërësi janë realizuar.Numri i përgjithshëm i lëndëve të arriturat pa llogaritur preventivën për periudhën raportuese ishte 197.lëndë të reja civile të cilat janë në procedurë pesë prej tyre janë vendosë në Gjykatën Themelore në Pejë Dega në Istog në tri raste ankesa kanë paraqitë paditësit ,me ç'rastë përgjegjja në ankesë nga ana e këtij organi I është dhanë në afatin e parapar ligjor.Në dy raste ankesë është paraqitë nga ana e Avokaturës Shtetërore.

Për vitin raportues janë ndërmarrë masa preventive në 87.raste e për të cilat nuk ka patur nevoj të caktohen seanca gjyqësore e as të ngritet padi.Në këto raste kontestet zakonisht janë zgjidhë me marrëveshje jashtëgjyqësore për puntorët shëndetësor.

Avokatura publike ka rolin e palës aktive në procedurë e për këtë ka marrë pjesë drejtëpërdrejtë në 37. seanca gjyqësore pran Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Istog në 6.seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë –Departamenti krime të rënda Pejë .Për çdo padi të re janë paraqitë përgjegjejt e afatëshme në padi si dhe mjetet e rregullta juridike dhe parashtrës tjerë gjatë procedurës.Nga viti paraparak sit ë pa vendosura janë bartë tetë lëndë nga se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit të gjitha lëndë të cilat ende janë në procedurë të rregullt në shkallë të parë e që kanë implikime buxhetore dhe financiare e obligojnë Gykatën që ta pezulloj procedurën ex officio dhe për këtë e njofton Ministrin për Financa dhe Ministrin e Drejtësisë , prej tyre në periudhën raportuese për shkak se ende afati nuk ka skaduar për 6 lëndë ende nuk është mbajtur seancë e re kurse dy kërkesëpadi janë refuzu si të pa bazuara.

Vëllimi i punës për periudhën raportuese ishte në rritje e sipër nga se me caktimin e përmbaruesve privat numri I propozimeve për përmbarim është në rritje Në çeshtjet përmbarimore numri I lëndëve është 392.lëndë.Përpunimi i padive dhe parashtrësve tjerë për këtë periudhë ishte në nivelin profesional,kjo nga fakti se nuk kemi patur asnjë rastë të kthimit për plotësim apo hudhjes së padisë.Edhe përkundër vështirësive objektive ku puna kryhet vetëm nga një punëtorë duke përfshirë edhe të gjitha punët administrative ato të daktilografimit,pranimit dhe protokolimit të postës rezultatet janë evidente

Pasiqë dinamika e zgjedhjes dhe e kryrjes së lëndëve nuk varet nga puna e këtij organi por nga Gjykata dhe organet tjera kompetente të vendosjes të cilat edhe e zhvillojnë procedurën

ndërmarrja me kohë e veprimeve procedurale tërthorazi mund të ndikoi dhe kontribuoi në zgjidhjen më të shpejtë të çështjeve të parashtruara. Sa seanca i cakton gjykata dhe si do të vendoset një çështje kontestimore nuk mvaren nga dëshira dhe vullneti i Avokatit Publik Komunal. Intencë dhe qëllim i këtij organi ka qenë dhe do të mbesë zgjidhja sa më e shpejtë dhe efikase e çështjeve të parashtruara.

Një kordinim dhe bashkëveprim më i mirë posaqërisht me Gjykatën Themelore në Pejë Dega në Istog me siguri do të reflektohej edhe në rezultatin e punës së dyanshëme dhe zvoglim të epsheve për pasurim pa bazë dhe uzurpim të pronës publike.

Lëndët që janë marrë në shqyrtim çdo herë janë përpunuar brenda afatit ligjor duke i respektuar edhe afatet gjyqësore për ndërmarrjen e masave konkrete. Për realizimin e detyrave të punës nga ana e këtij organi janë paraqitë mësë 46. parashtrës të ndryshme në formë të kundërshtimeve, prapësimeve, përgjegjjeve në padi kërkesave dhe propozimeve. Duhet patur para syshë edhe faktin se numri i lëndëve të zgjidhura drejtpërsëdrejti është i lidhur edhe me azhuritetin e punës së gjykatave dhe organeve tjera kompetente që zhvilloin procedurën sipas padisë gjegjësisht parashtrësës tjetër të avokaturës publike. Në munges të numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve kemi edhe bartje të lëndëve për shqyrtim prej vitit në vit.. Lëndë për të cilat procedura është filluar në vitin 1999-2010 e që janë bartë për vendosje në periudhën raportuese janë gjithësejt 12.

Sipas padisë së Avokatit Publik procedura nuk kemi patur raste të reja, në 13 raste paditës kanë qenë përsoneat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në shkallë të dytë sipas ankesës së avokatit publik janë 111 lëndë kurse sipas ankesës së përsoneave fizik dhe juridik në shkallë të dytë janë 16 lëndë, në raste tjera procedura është pezullu për kohë të pa caktuar.

Para fillimit të procedurës kontestimore ose procedurës tjetër avokatura publike ka ndërmarrë masa preventive me qëllim të zgjidhjes së kontesteve me marrëveshje dhe mirëkuptim.

Mbrojtja e të drejtave dhe interesave pronësore të subjekteve shoqërore

Avokatura Publike Komunale kryen edhe mbrojtjen juridike të pronës dhe interesave pronësore të subjekteve shoqërore. Kujdes i posaqëm në këtë drejtim i është kushtuar lidhjes së punëve juridike në ç' drejtim janë vërejtur dobësi të caktuara e shprehur në formë të lidhjes së kontratave për bashkëndërtim në troje të pa ndërtuara në pronësi shoqërore. Edhe përkundër përpjekjeve që përmes bashkëpunimit me organet komunale të arrihet gjer ke synimi i tyre një çështje e tillë nuk është përkrahë dhe si e tillë ka ngelë vetëm në tentativë. Detyrë me prioritet për këtë organ ka qenë edhe ruajtja e fondit të banesave në pronësi publike komunale, privatizimi i të cilave është në përfundim. Për këtë është më se e domosdoshme që në rastet kur atakohet prona publike dhe shoqërore shfrytëzuesit e pronës shoqërore me kohë ta njoftojnë shërbimin pronëso-ro-juridik dhe avokaturën publike që me kohë ti shkëputen rrënjët dukuris së përvetësimit të pronës publike.

Gjendje e ngjajshme mbretëron edhe në mbrojtjen e fondit të banesave, posaqërisht sa i përket qeshtjes së bashkëpronësisë në banesa dhe në sipërfaqe banesore.

Problem të posaqëm për këtë organ gjatë periudhës raportuese janë statusi i pa determinuar i marrëdhënjeve juridiko- pronësore dhe hipotekat e krijuara në decenjen e fundit nga okupimi i pushtetit shtetëror në Kosovë nga pushteti serbë. Rastë tipik i kësaj natyre është edhe mosrregullimi i marrëdhënjeve pronësore në Burgun e Dubravës.

Orjentimi programues për gjashtëmujorin e dytë korik-dhjetor 2022

Orjentim themelor në punë i Avokaturës Publike Komunale në vitin 2022 do të jetë realizimi konsekuent dhe efikas i kushtetutëshmërisë dhe ligjëshmërisë në punën e kësaj avokature, në sigurimin sa më të sukseshëm dhe efikas të të drejtave pronësore dhe interesave të të gjitha subjekteve të cilat kjo avokaturë i përfaqëson.

Për këtë vit vijues aktivitetet e këtij organi do të orjento-hen në:

-Realizimin e detyrave që dalin nga plani operativ i masave dhe aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Istogut.

-Në realizimin konsekuent të veprimeve preventive veqanërisht kur kemi të bëjmë me informimin me kohë të organeve kompetente të cilat duhet të ndërmarrin masa për respektimin e

ligjëshmërisë në disponimin dhe shfrytëzimin e pronës publike.

-Kujdes i posaqëm do t'i kushtohet zbatimit konsekuent të dispozitave të Ligjit mbi uzurpimin arbitrar të tokës në pronësi shoqërore, Ligjit mbi Tokën Ndërtimore dhe dispozitave të Ligjit për Shpronësimin nga fakti i atakimit më të shpeshtë të këtyre formave të pronësisë.

Përcjellja dhe studiimi i marrëdhënjëve shoqërore

Njëri ndër parakushtet për mbrojtjen efikase të pronës publike është zbulimi me kohë i dukurive të cilat këtë pronësi e dëmtojnë ose e rrezikojnë. Zbulimi me kohë i këtyre dukurive dhe përcjellja sistematike e zhvillimit të tyre mundëson ndërmarrjen e masave konkrete dhe efikase për çrrënjosjen e këtyre dukurive. Për arritjen e efikasitetit të dëshiruar në këtë drejtim është më se i domosdoshëm një bashkëpunim më i mirë dhe kordinim i veprimeve me institucionet tjera kompetente për ndërmarrjen e masave konkrete kur kjo nuk është në kompetencën e avokaturës publike komunale. Një bashkëpunim i mirë në këtë drejtim është me Drejtoratin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoratin për Arësim e posaqërisht me Drejtoratin për Urbanizëm, Katastës dhe Mbrojtje të Mjedisit të Kuvendit të Komunës së Istogut.

Me pasqyrimin e rezultateve të arritura dhe lëshimeve të konstatuara me mundësi të paraqitjes së vërejtjeve sygjërimeve dhe propozimeve shpresojmë që do të ndikohet drejtpërdrejt në efikasitetin e punës së Avokaturës Publike Komunale e me këtë edhe organeve tjera komunale në përgjithësi. Për këtë vërejtjet sygjërimet dhe propozimet e paraqitura me bazë janë të mirëseardhura

QENDRA PËR SHËRBBIM ME QYTETAR

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Qendra për shërbim të qytetarëve. Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2022, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtorateve, kryetarit dhe kuvendit.

I. Numri i kërkesave sipas Drejtorateve, për Gjashtë muaj:

Nr.	Drejtorati/Departamenti	Të pranuar	Të arkivuara
-----	-------------------------	------------	--------------

00	Kuvendi Komunal	06	3
001	Zyra e Kryetarit	119	98
02	Drejtoria e Administratës	26	15
03	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster dhe Pronë	595	235
04	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim,	32	54
05	Drejtoria për Arsim	401	295
06	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	159	95
07	Drejtoria e Inspektionit	51	30
08	Drejtoria për ShPMSH	292	150
08	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomi	186	102
10	Zyra për Komunitete dhe Kthim	30	20
11	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	170	98
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	62	30
13	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	7	0

Gjithsej:	2.136+1.225 =3.361
-----------	-----------------------

Numri i dokumenteve të lëshuara/ procesuara për Gjashtë muaj:

Nr.	Lloji i dokumentit	Totali
1.	Deklaratë për Mbajtës të Familjeve	159
2.	Protokoli dalës shkresa të Ministrive të protokoluara	102
3.	Ekspedimi i postës Rek. dërgesave në postë- përgjigje nga Drejtoratet K.K	200

4.	Pranimi i dërgesave nga posta në K.K-Istog	350
----	--	-----

Gjithsej:	811
-----------	-----

Pagesat e administratës për Gjashtë muaj:

Nr.	Lloji i dokumentit	Shuma(€)
1	Pagesat e Administratës-Palët	854
2	Pagesa në Arkë	1,817

II. Të liruar nga pagesa për Gjashtë muaj:

Të liruar:	963
------------	-----

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Drejtoria për Administratë Komunale është drejtoria më e madhe dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësi, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë.

Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të ¹¹

përbushjes se kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Në kuadër të këtij drejtorati për këtë periudhë raportuese janë marrë keto veprime për realizimin në keto projekte:

1. "Blerja e pajisjeve të Teknologjisë Informative për nevoja të institucioneve komunale në Istog", vlera 10.000 €;
2. "Mirëmbajtja e objekteve komunale në komunën e Istogut", vlera 35.000 €;
3. " Funksionalizimi I e-Kioskës - komuna e Istogut", eshte me funksion te qytetareve
4. Digjitalizimi i shërbimeve në administratën komunale (E- shërbimet).
5. Inicimi I blerjes se veturave per nevoja te Komunes -120.000 c
6. Inicimi per mirembajtjen e Objekteve te Administratës komunale – 20.000 €;
7. Është bërë Instalimi i ID Certifikates Digjitale ne 6(gjashtë) E-Kiosqe në 5 Zyrat e vendit dhe ne hapësirat e oborrit te objektit të Komunës ku qytetarët nund ti tërhyekin 5 dokumente te Gjendjes Civile 24/7 e cila do te funksionalizohet keto ditë.
Certifikatat te cilat mund te terhiqen ne e-kiosqe janë:
 - Certifikatën e Lindjes
 - Ekstraktin e Lindjes
 - Certifikatën e Martesës
 - Certifikatën e Shtetësisë dhe
 - Certifikatën e Vendbanimit

8.Komuna në bashkëpunim me ASHI (Agjensionin e Shoqeërisë së Informacionit) ka plasuar përmes Platformës E- Kosova e cila është vendosë edhe në web faqen e komunes se Istogut kk.rks-gov.net/istog ku qytetari mund te aplikoj dhe ti terhyek dokumentet e gjendjes civile online e qe jane valide per te gjitha sherbimet brenda Kosovës.
- Poshtu permes Platformës E-Kosova Komuna në bashkëpunim me ASHI ka bere te mundur aplikimin qe qytetari te beje pagesen e faturës per takse komunale per regjistrim te automjeteve.

9.Komuna në bashkëpunim me MAPL eshte duke bere rifreskimin dhe azhurimin e Intranetit komunal ku pala permes Intranetit ne 3 faza mund te aplikoj per Leje Ndertimore.

Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato deri tani janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë. Drejtorja për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Qendra për shërbim të qytetarëve;
3. Arkivi komunal;
4. Zyra e prokurimit publik dhe
5. Zyra për të drejtat e njeriut dhe Komunitete.

Sektori për shërbimin e gjendjes civile dhe zyrat e vendit. Me qëllim që qytetarët t'i kenë më afër shërbimet e tyre, funksionojnë edhe zyrat e vendit: Zyra e vendit në Banjë, Vrellë, Rakosh, Gjurakoc dhe Dobrushë ku qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale pa pasur nevojë të vijnë në Istog. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë, e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në këto qendra: Istog, Gjurakoc, Vrellë, Banje dhe Dobrushë dhe Rakosh. Në kuadër të punëve të rregullta administrative nga administrata e përgjithshme bëhet regjistrimi në librin amë të të lindurve, të kurorëzimit dhe librin amë të vdekurve. Gjithashtu ushtrohen edhe procedura të tjera administrative siç janë: dhënia e vërtetimeve të ndryshme mbi vendbanimin, gjendjes familjare, martesore etj, pranimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme të drejtuara organeve komunale, vërtetimi i dokumenteve zyrtare, ndihma të rregullta juridike për qytetarët.

Ekstrakti i lindjes brenda Vëndit	3169
Ekstrakti i lindjes Jashtë Vëndit	2718
Certifikata e lindjes brenda Vëndit	1791
Certifikata e lindjes Jashtë Vëndit	4883
Certifikata e martesës brenda Vëndit	1103
Certifikata e martesës Jashtë Vëndit	2090
Certifikata e vdekjes brenda Vëndit	464
Certifikata e vdekjes Jashtëa Vëndit	444
Certifikata e vendbanimit brenda vëndit	739
Certifikata e vendbanimit jashtë Vëndit	464
Certifikata e bashkësisë familjare brenda vëndit	337
Certifikata e bashkësisë familjare jashtë vëndit	1697
Certifikata e gjendjes martesore brenda vëndit	198
Certifikata e gjendjes martesore jashtë vëndit	292
Certifikata e shtetësisë brenda vëndit	49
Certifikata e shtetësisë jashtë vëndit	129
Vërtetim nga arkiva brenda vemdit	152
Vërtetim nga arkiva jashtë vemdit	197
TOTALI	20916

2. Janë pranuar 9 kërkesa dhe janë lëshuar 9 aktvendime në LAL
3. Janë pranuar 42 kërkesa dhe janë lëshuar 42 aktvendime në LAV

Gjithsejt për periudhën 01.01.2022 deri më 30.06.2022 , në total 90 lëndë

Raporti për periudhën 01.01.2022 deri më 30.06.2022				
Lindje të rregullta	20			
Lindje të veçanta	14			
Vdekje të rregullta	32			
Vdekje të veçanta	6			
Martesa të rregullta	57			
Martesa të veçanta	12			

Arkivi komunal. Në kuadër të administratës kryhen edhe shumë punë të përbashkëta administrative për nevoja të organeve komunale, nder to edhe arkivimi i të gjitha shkresave dhe lëndëve të rëndësishme.

Për periudhën raportuese Janar-Qershor të vitit 2022 puntorët e Arkivit Komunal në Istog janë orjentuar në ndarjen dhe klasifikimin e lëndës arkivore .

Per periudhen raportuese gjashtemujore janar qershor 2022 jane shqyrtu 10 (dhjete) kerkesa te pa/eve.

Kerkesat qe jane paraqite jane edhe te natyres se studiimit dhe hulumtimit te lendes arkivore me qellim te pergaditjes se temave te diplomes per studimet post diplomike.

Ketyre studiuesve ne tri raste u eshte ofruar lende e mjaftueshme arkivore per hulumtime shkencore.Te kesaj natyre jane paraqite tri kerkesa.

Eshte shtuar edhe numri I kerkesave edhe per hulumtimin e lendes arkivore sa i perkete eshtjes se arsimit ne periudhen 1989-1999 .Interesimi kryesore ka qene ofrimi i lendes arkivore per menyren e organizimit te mësimit ne Shtepitë Shkollat, sfidat dhe peripetit qe i kanë perjetu nxenesit dhe mesimdhënesit e kesaj periudhe ne keto shtepi shkolla .Kryesisht ne kete drejtim me muaj te tere I eshte ofruar material arkivor me qellim te botimit te tij autorit Bajram Shatri. Fokus kryesor i tij ka qene funksionimi I shtepive shkolla ne Komunen e Istogut .

Nuk eshte i vogel edhe numri i kerkesave ne rritje kryesisht nga Ministria e Puneve te Brendeshme e Kosoves ,gjegjesisht Njesiti I Hulumtimit te Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

Kerkesat kishin te benin kryesisht me hulumtimin e lendes arkivore qe kishte te bente me evidencen e veteraneve te Ushtrise lirimtare te Kosoves .

Aktiviteti i Ushtrise Çlirimtare të Kosoves ne periudhen 1998-Qershor- 1999. Qellim i hulumtimit te lendes arkivore te kesaj natyre ishte pasqyrimi I qarte I te dhenave per evidencen qe posedon Arkivi I Komunes se Istogut per Ushtaret e Ushtrise lirimtare te Kosoves ,invalideve te luftes,vetreaneve te luftes,viktimave civile te luftes dhe deshmoreve.Njekosisht ketij Komisioni hetimor I eshte kerkuar edhe ofrimi I lendes arkivore qe eshte siguru nga Shtabi I U K-s per Rajonin e Dukagjinit ,kuptohet per eshtjet qe nuk jane sensitive (qe nuk paraqesin secret zyrtare). Nga te dhenat e ofruara ekipi I hetuesve u nda I kenaqur me lenden e ofruar arkivore ne sherbim te tyre.

Per periudhen raportuese numri I kerkesave qe kishin te benin me sigurimin e te dhenave per ndryshimet statusore te qytetareve si jane ndryshimi I emrit,mbiemrit ,germezimet e lejuara nga Gjendja civile per eshtje statusore per te cilat u eshte lejuar me aktvendim ndryshimi I eshtjeve statusore .

Eshte shtuar edhe numri I kerkesave te paraqitura nga bizneset private per veprimtarin ekonomike qe kan zhvilluar ne periudha te ndryshme kohore. Kerkesat kishin te benin me ofrimin e te dhenave qe posedon arkivi Komunal me stazhin e punes se ketyre veprimtarive afariste,per realizimin e te drejtes ne pension dhe te drejtave tjera qe rrjedhin nga marredhenja e punes.

Eshte punuar ne klasifikimin e lendes arkivore qe eshte dorezuar nga punetorja e Arkivit Komunal Znj Xhevahire Ibrahimaj.Kjo lende arkivore eshte pranuar ne gjendjen siq ishte-I pa klasifikuar. Per kete jemi perkushtu ne klasifikimin e kesaj lende arkivore me qellim ruajtje.

Eshte pranuar edhe material arkivor nga Zyra e Prokurimit.Materiali akivor I dorezuar nga kjo zyre nuk eshte pranuar me procesverbal nga se nuk ishte I sistemuar dhe evidentuar siq e kerkon Ligji per Arkivat dhe Udhezimi Administrativ per klasifikimin e lendes arkivore .

Lendo arkivore e dorezuar pa procesverbal dhe regjister te lendes arkivore te futur ne regjistratore eshte e vitit 2009;2010;2013;2014;2015 dhe 2016.Klasifikimi I ketij materiali arkivor dhe arkivimi I tij mund te behet vetem pas pranim dorezimit te rregullt me procesverbal dhe regjister per secilin regjistratore.

Per shkak te kohes se kufizuar raporti eshte reduktuar per kete verejtjet sygjeimet eventuale te mundeshme jane te mireseardhura me kushte qe ne te ardhmen puna te perfeksionohet kurse ndonje leshim eventual te korrigjohet.

Në kuadër të këtij drejtorati funksionin Zyra e Prokurimit, e cila ndërmerr të gjitha aktivitetet e prokurimit për komunën, në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 Njësia e Prokurimit, pranë këtij Autoriteti Kontraktues ka proceduar aktivitete të prokurimit të cilat janë të përmbledhura në tabelën e më poshtme.

Shëno aktivitetet e Zyrës së Prokurimit për këta muaj.

	PLANI I PROKURIMIT PER VITIN BUXHETOR 2022 PERMBAN	98 - Aktivitete
	NUMRI I AKTIVITETEVE TE INICUARA DERI ME 30 QERSHOR 2022 ESHTË	35 - Aktivitete
	NUMRI I AKTIVTETEVE TE INICUARA DERI ME 30 QERSHOR 2022 ME PLAN TE PROKURIMIT ESHTË	27 - Aktivitete
	NUMRI I AKTIVTETEVE TE INICUARA DERI ME 30 QERSHOR 2022 ME PLAN TE PROKURIMIT ESHTË	8 -Aktivitete
	REALIZIMI I PLANIT TE PROKURIMIT DERI ME 30 QERSHOR 2022 ESHTË MBI	36%

ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE KOMUNITETE

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së është formuar Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete si mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, i cili funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuara.

Janë monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal, dëgjimeve me qytetarë, mbledhjet e KPF-së, mbledhjet e KKS-së dhe takime tjera në kuadër të komunës.

Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme.

Në periudhën Janar-Qershor 2022 janë mbajtur këto aktivitete të parapara me planin e punës:

- Tryezë dhe manifestim më rastin e shënimit të 8 Marsit "Dita Ndërkombëtare e Gruas". Tema kryesore e kësaj tryeze është "Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave";
- Vizitë në shfmu "Bajram Curri" në Istog, me qëllim verifikimi sa janë të mbrojtura të dy gjinitë, barabartë sipas ligjit (kontratat e punës, pagat dhe pushimet", në bashkëpunim me Zyrën e Personelit.
- Në bashkëpunim me Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport u shënuar 21 Marsi "Dita Botërore e Sindromes Daun" dhe mbjellën 21 lule në oborrin e OJQ "Handikos" nga këta persona dhe pas aktivitetit u mbajt një koktej rasti;
- Takim me qëllim të diskutimit lidhur me temën "Analiza dhe vlerësimi i kostos financiare për subvencionimin e pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetushqyese, përfituese të skemave sociale" në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsimit;
- Vizitë fermereve në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, me qëllim të vetëdijesimit të grave për mundësitë e përfitimit nga programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;

- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi u organizua një takim me qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Tema kryesore e kësaj tryezë “ E drejta në trashëgimi dhe pronë”;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit me rastin e shënimit të 1 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”, gjatë ditës vizituam të gjitha kopshtet e fëmijëve në Komunën e Istogut, duke i uruar për këtë ditë u shpërndan dhurata simbolike për fëmijët e të gjitha kopshteve;
- Në bashkëpunim me OJQ “Medika Gjakova”, tema e tryezës “Destigmatizimi dhe qasja sensitive ndaj të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”;
- Në bashkëpunim me OJQ “Vision 02” u mbajtën disa aktivitete për shënimin e 24 Qershorit “ Dita Ndërkombëtare e Egjiptianëve”.

DREJTORIA PËR INSPEKSION

RAPORT PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2022

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar – Qershor 2022, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikçyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale.

Përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e ndërtimit (me 2 pozita inspektoriale), sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë).

Gjatë periudhës raportuese, si rezultat i aktiviteteve inspektuese të realizuara në vazhdimësi në terren, janë arritur rezultate konkrete në mbikçyrjen e zbatimit të ligjshmërisë, siç është prezantuar në të dhënat vijuese, e që kanë të bëjnë me:

1. Ruajtjen e brezit mbrojtës të rrugëve regjionale dhe lokale, në territorin e Komunës me ç’rast janë:
 - hartuar 81 procesverbale.
 - janë lëshuar 9 aktvendime .
 - 12 rrethime të objekteve.
 - 17 ri- inspektime
 - 1 pezullim të lejes së ndërtimit.
 - 6 përgjigje në bazë të kërkesës së pales.
 - 6 gjoba mandatare.

- 1 pëlqim.
- 1 vendim.

2. Punët e Inspektorit të Ndertimit - Zona Urbane

Punët e Inspektorit të Ndertimit për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës Janar – Qershor 2022 të Zyrës së Inspeksionit dhe planit operacional të hartuar nga bartësi i pozitës.

Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të kompetencave të akteve ligjore në fuqi për pozitën e punës së lartëshënuar dhe ka qenë i fokusuar në :

- Inspektime për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të "Ligjit Ndertimit"

Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndertimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale , kontrollimi, evidentimi , inçizimi dhe ndërmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndjekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike.

Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veçantë në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste.

Ku gjatë ketyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane Istog, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë janë bërë 19 inspektime dhe 34 ri-inspektime , 48 procesverbale , 5 aktvendime 5 gjoba mandatare.

Me aktvendim u është ndëprerë puna 5 objekteve të ndertimit .

Kemi pranuar 16 kërkesa nga investitorët dhe punkryesit e punimeve të objekteve për të bërë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndertimit siq parashihet me ligj të ndertimit.

Njoftim për Policinë e Kosovës, stacioni policor në Istog për asistencë në ndërprerjen e punimeve për 2 objekte.

Po ashtu 1 kërkesë i është drejtuar : Drejtoratit për Kadaster dhe Gjeodezi për dalje të gjeodetëve në teren për inçizim të parceles .

3.Mbikëqyrjen e fushës së tregtimit, qarkullimit dhe ekspozimit të mallrave, dhe të shërbimeve, si dhe ligjshmërisë së funksionimit të veprimtarive të tilla biznesore janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë hartuar 57 procesverbale.
- Janë hartuar 5 procesverbale lidhur me plotësimin e kushteve higjeniko-sanitare dhe kushteve tjera minimale –teknike për subjektet të cilat kanë filluar ose vazduar aktivitetin e tyre afarist.
- Janë lëshuar 5 aktvendime për plotësimin e kushteve minimale tekniko-sanitare dhe dhënja e pëlqimit për ushtrimin e aktivitetit afarist .
- Janë hartuar 10 procesverbale gjatë kontrolleve rutinore nëpër markete dhe supermarkete, duke u nisur nga dukuria e ngritjes së çmimeve për artikujt ushqimor siq janë siq janë vaji, sheqeri , vezët etj.
- Janë lëshuar 2 gjoba mandatare .
- Janë hartuar 6 procesverbale , inspektime të jashtëzakonshme në bashkveprim me Policinë e Kosovës , lidhur me rrespektimin e orarin e caktuar të punës për subjektet afariste.
- Janë hartuar 5 procesverbale lidhur me shitjen e mallrave dhe artikujve ushqimor me pakicë në vende publike të ndaluara jashtë lokaleve afariste, ku pengohet qarkullimi i lire i qytetarëve në trotuare.
- Janë hartuar 13 procesverbale lidhur me inspektimin e furrave të bukës
- Janë hartuar 5 procesverbale lidhur me shitjen e disqeve për prerjen e metalit dhe betonit me afat të skaduar , disqet me afat të skaduar janë konfiskuar me procesverbal.
- Janë hartuar 5 procesverbale lidhur me rrespektimin e vendimit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë për çmimin maksimal të lejuar për naften dhe produktet e naftës.
 - Janë lëshuar 6 aktvendime për shqiptimin e gjobave.
 - Është hartuar 1 procesverbal lidhur me ankesën e konsumatorit.

4. Në sektorin e mbrojtjes së mjedisit - ambientit,
Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë hartuar 6 procesverbale inspektuese .
- Gjatë kësaj periudhe raportuese Inspektorit të Mjedisit i janë parashtruar 8 kërkesa-ankesa.
- Është hartuar 1 procesverbal për ndërprerje të aktivitetit me urdhër të MMPHI –së.

5. Në sektorin e komunikacionit:

Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të Ligjit Nr.04/L-179 Për Transportin Rrugor dhe Rregullores Komunale Nr.5/2014 .

Në bazë të kompetencave të lartcekura Inspektori i Komunikacionit ka paraqitur këtë raport të aktiviteteve të kryera .

14 Inspektime të operatorëve ekonomik të transportit publik të udhetareve me autobus në territorin e komunës së Istogut.

15 Inspektime të operatoreve të transportit me auto-taxi në territorin e komunës së Istogut.

Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën Janar – Qershor 2022, kësaj Drejtorie i janë parashtruar edhe kërkesa tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në terren të cilat kanë marrë përgjegje mbrenda afatit të paraparë ligjor.

DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA **RAPORTI I PUNES 6 MUJOR, JANAR-QERSHOR, 2022**

Sektori Pë Buxhet Dhe Thesar

- Korniza Afatmesme Buxhetore(KAB) Për vitin 2022/2024 është dorëzuar në fund të shtatorit/2021 në Thesarin Qendror-MEF.Plani i të hyrave për Komunën dhe plani i shpenzimeve të Komunës për vitet 2022-2024.

- Të hyrat vetanake janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale mbi të Hyrat, në të cilën janë determinuar cilat të hyra ka të drejtë t'i arkëtojë komuna si: tatimi në pronë, taksat për dhënie të lejeve të ndërtimit, taksat nga licencat e lokaleve, taksat e shërbimeve komunale si dhe të hyrat nga dënimet e shqiptuara, në komunikacion etj.

- Dhënia e shënimeve të përditshme mbi buxhetin dhe shpenzimet buxhetore nga SIMFK-FreeBalance.

Në vijim po paraqesim burimet e financimit të Buxhetit për vitin 2022 dhe realizimi i shpenzimeve prej 01.01.2022 gjerë më 30.06.2022.

BURIMET E FINANCIMIT PËR VITIN 2022	PLANI I BUXHETIT 2022	SHPENZIMET BUXHETORE 2022	SHPENZIMET BUXHETORE TË REALIZUARA NË %
1	2	3	4
10.GRANTI QEVERTAR 2022	10,501,089.26	3,813,419.89	36.32%

21.TE HYRAT VETANAKE 2022	1,160,615.00	64,335.99	5,55%
31.MJETE BUXHETORE GRANT NGA DONATORET E MBRENSHEM	10,669.32	0.00	0.00%
06.FINANC.HUAMARRJE PER KLAUZ.INVEST. -Ndertimi i skemes per furnizim me uje ne Komunen e Istogut	144,806.00	0.00	0.00%
73. USAID	3.18	0.00	0,00%
93.COUNCIL OF EUROPE	520.00	0.00	0.00%
TOTALI I PËRGJITHËM 2022:	11,817,702.76	3,877,755.88	32.82%

Shënim:Në Tabelen e mësipërme janë paraqitur të dhënat nga Raportet SIMFK FreeBalance të datës 08.07.2022.

Nga shifrat nga tabela shihet trendi i mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara nga Buxheti Granti Qeveritar dhe Të Hyrat Vetanake Komunale nga niveli lokal 2022 dhe të mjeteve të tjera për këtë periudhë raportuese.

Trendi i shpenzimeve dhe përcaktimi i tyre varet kryesisht nga trendi i të hyrave vetanake të arkëtuara të cilat janë kontribut i qytetarëve nga tatimi dhe taksat e ndryshme komunale nga të cilat varet realizimi projekteve parësore të komunës të cilat projekte kryesisht janë në të mirën e qytetareve me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe standardin jetësor .

Të Hyrat Vetanake Komunale

Të Hyrat Vetanake Buxhetore për Organizatën Buxhetore për të gjitha Programet dhe Nen programet Buxhetore kryhen nga Zyrtari/ja për të Hyrat Komunale.

Te hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2022 janë në shumë prej 1,160,615.00 €. Nga data 01.01.2022 deri 30.06.2022 janë mbledhur (arkëtuar) të Hyra Vetanake Komunale në shumën prej 586,397.99 € në përqindje të 50,52 %.

Janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- Përpunimi i të Hyrave Komunale dhe ndarja sipas Kodeve ekonomike
- Regjistrimi i të Hyrave vetanake në sistemin FreeBalance
- Përcjellja e arkëtimit të të Hyrave Vetanake Komunale
- Kerkesat për Alokimin e të Hyrave Komunale në Thesarin Qendror
- Barazimi i të Hyrave Komunale me Thesarin Qendror
- Raportet mujore,tremujore dhe gjashtëmujore të Hyrave Komunale dhe barazimi i tyre
- Barazimi dhe menagjimi i të Hyrave vetanake Komunale sipas Planit vjetor të Aprovuar.

Zotimet e mjeteve.

Zotimet e mjeteve Buxhetore për Organizatën Buxhetore për të gjitha Programet dhe Nen programet Buxhetore kryhen nga Zyrtari Zotues.

Zotimet gjatë periudhës gjashtëmujore janë kryer me sukses, gjithashtu janë kryer këto punë dhe detyra të punës janë bërë regjistrimet e zotim/ obligimeve dhe kërkesave të zotuarra gjithsej janë 1,393 lëndë UOP(Urdhër Obligimi për Pagesë) dhe KZB (Kërkesa Zotim për Blerje) të gjitha këto lëndë janë Regjistruar ne SIMFK(Sistemi i Menagjimit të Financave të Kosovës).

Punët e kryera për Zotimet e lëndëve:

- Regjistrimi i zotim/obligimeve ne sistemin FreeBalance për Programet dhe Nënprogramet Buxhetore të Komunës .
- Punët profesionale, administrative dhe nxjerrja e raporteve për pozitën financiare të Komunës nga SIMFK -Thesari-FreeBalance .
- Punët mbi sigurimin-kontrollin e nënshkrimeve të zyrtarëve përkatës në formularin UOP (CPO),KZB-Kerkesave Zotim për Blerje .
- Konsultimet me Zyrtaret Autorizues dhe Zyrtaret Administrativ dhe dorëzimi i Urdhër Obligimeve UOP dhe KZB-Kerkesave Zotim për Blerje zyrtarëve autorizues për procedim të procedurave të mëtutjeshme.

Shpenzimet e mjeteve Buxhetore

Shpenzimet e mjeteve Buxhetore për Organizatën Buxhetore për të gjitha Programet dhe Nen programet Buxhetore kryhet nga Zyrtari Shpenzues.

Gjatë periudhës gjashtëmujore 01.01.2022 deri 30.06.2022 janë proceduar ne sistemin SIMFK-FreeBalance të gjitha lendet qe kan ardhur për procedim nga të gjitha Programet dhe Nënprogramet Buxhetore.

Është berë procesimi dhe futja në sistem FreeBalance i 1,356 lëndëve.Të gjitha këto lëndë janë skanuar faturat, janë emëruar faturat dhe janë procesuar dhe futur ne në sistemin SIMFK-FreeBalance,(Sistemi Informativ për Menagjimin e Financave të Kosovës).

Gjatë gjithë kësaj periudhe janë zbatuar të gjitha procedurat e Thesarit të Kosovës janë zbatuar me përpikëri të gjitha udhëzimet dhe Rregulloret në fuqi.

Gjithashtu janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- Është berë pranimi i të gjitha lëndëve nga Zyrtaret e Pranimi dhe Zyrtarët tjerë që janë në lidhmëri më procesin e shpenzimeve nga Buxheti Komunal.
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit pa Urdhër Blerje (UOP)dhe verifikimi i furnitorëve dhe llogarive Bankare te të gjithë operatoreve ekonomik.
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit me Urdhër Blerje që rrjedhin nga procesi i prokurimit(Lëndët që kan të bejnë më procesin e prokurimit)
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimeve të Parave të Imëta(Petty Cash)
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit për Avanset për Udhëtime Zyrtare jashtë shtetit sipas procedurave të Thesarit.
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit për Avanset për Udhëtime Zyrtare Mbyllja e Avanseve sipas procedurave të Thesarit.
- Regjistrimi i Kuponave të Shpenzimit për Shpenzimet dhe Paraja e vogël gjepi për udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Pasuritë, Regjistrimi i pasurisë

Regjistrimi i pasurisë për Organizatën Buxhetore për të gjitha Programet dhe Nen programet Buxhetore kryhet nga Zyrtari/ja për pasuri.

Gjatë periudhës 01.01.2022 deri 30.06.2022 janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Të gjitha lëndet të cilat kanë përfunduar procedimin e pagesave në shumat totale me situacione prej 1,2,3,4,5 dhe 6 apo me shumë situacione janë proceduar lëndet që kanë mbetur për procedim-regjistrim nga viti paraprak për shkak të procedurave që parasheh thesari.

- Janë kopjuar, skanuar të gjitha lëndet e nevojshme për tu regjistruar në SIMFK-Pasuritë.
- Gjithashtu janë regjistruar lëndet të cilat i kanë plotësuar kushtet për regjistrim në SIMFK-Pasuritë.
- Pritet të bëhet procedimi dhe futja në sistem e lendeve të Projekteve Kapitale që kanë përfunduar dhe kanë qenë për procedim nga Ministrit e linjës për vitin 2021/2022.
- Gjatë periudhës gjashtëmujore vijuese të pjesës së dytë pritet që të kemi një fluks më të madh të kryerjes së Projekteve kapitale.

Sektori i Financave

Sektori i Financave gjatë kësaj periudhe ka kryer punë në harmoni me planin e punës si dhe punë tjera të cilat janë caktuar nga ana e eprorit.

Janë pranuar gjithsej 1356 lëndë nga ana e zyrtarit për shpenzime të cilat janë kontrolluar, certifikuar dhe janë aprovuar për mes të sistemit të Fribalancit pasi që kompetencat kanë kaluar neper Komuna.

Gjatë kontrollës si lëndë të pa kompletuar dhe që janë kthyer të personat përgjegjës për tu kompletuar janë, 12 lëndë.

Të gjitha këto lëndë janë regjistruar në një program të exellit për evidencë të njëjtat lëndë janë dorëzuar të zyrtarja për arkivim të lendeve. Në protokollin e Drejtoratit tonë janë evidentuar 28 shkresa të ndryshme.

Me Kërkese të palëve për këtë periudhë janë lëshuar gjithsej 106 Certifikata të gjendjes ekonomike për qëllime të ndryshme (për botën e jashtme, për nevoja personale ndihma sociale etj). Gjithashtu janë lëshuar 4189 fatura për pagesën e taksës Komunale për regjistrimin e automjeteve.

Sa i përket pagave janë përcjellë në Ministrinë të gjitha ndryshimet për Janar Qershor 2022, janë nënshkruar dhe dorëzuar Listat e pagave për muajt Janar- Qershor 2022. Ka kalkuluar pagat e këshilltareve të Asamblesë Komunale për periudhën Janar Qershor 2022 dhe

Janë dorëzuar në Ministri, gjithashtu është kryer kalkulimi i pagave të punëtorëve për shërbime të veçanta dhe janë bërë pagesat.

Të hyrat nga taksat dhe ngarkesat Komunale që janë inkasuar dhe dorëzuar në bankë për mes Arkëtares Komunale (Pagesat deri në 10 €) kapin shumën prej 71929 €.

Zyrtarja për arkivimin e lëndëve të Thesarit i ka arkivuar të gjitha lëndet origjinale që janë aprovuar si pagesa gjithsej 1356 lëndë.

Gjithashtu nga zyrtarja për pranimin dhe protokollimin e faktuarve janë protokolluar gjithsej 1091 fatura.

Janë hapë gjithsej 1 petty cash të cilët janë me shumë prej 1000,00 €, i cili është në procedurë të shpenzimit.

RAPORTI 6 MUJOR I PUNES 2022 PER TATIMIN NË PRONË

Në kuadër të punëve dhe detyrave të punës të ZKTP, gjatë periudhës gjashtë mujore, prej 01.01.2022 deri më 30.06.2022 janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- **Lëshuarja e faturave tatimore për vitin 2022** - Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar gjithsej **9.476 fatura** për tatimin në pronë për të gjitha pronat që deri më tani janë të evidentuara dhe që i nënshtrohen tatimit në pronën e palujtëshm. Numri i pronave për objekte është **11.334** ku janë të përfshira objektet e banimit, afarizmit, industriale dhe bujqësore, si dhe **22.287** parcela në total, prej të cilave parcelat bujqësore janë të liruara nga tatimi. Ndërsa tatimohen parcelat rezidenciale, afariste, industriale dhe bujqësore.
- **Shuma e faturuar** - për këtë vit tatimor, shuma e faturuar për objekte është **397.385,00 €** dhe për parcelat **152.721,00 €**, që në total faturimi është **550.107,00 €**.
- **Shpërndarja e faturave** - Edhe këtë vit kalendarik shpërndarja e faturave është kryer përmes PK-ës (Postes së Kosovës) – Njësia në Istog.

Sipas Raportit mbi pranim-dorëzimin e dergesave të tatimit në pronë për këtë vit, të pranuar nga PK-ës më datën 09.06.2022, gjendja e shpërndarjes është si në tabelë:

Nr.faturave	Shpërndarja	Mbetja	Përqindja e shp.
9.476	9.226	250	97.36 %

Mbetja e 250 faturave të pashpërndara kryesisht është për arsye se: pala ka ndërruar vendbanim dhe adresë jo të sakta.

- **Regjistrimi i objekteve te reja dhe verifikimi i atyre ekzistuese-** sipas shenimeve të grumbulluara nga terreni dhe matjeve të kryera ne teren , për këtë periudhe raportuese janë regjistruar ne sistem gjithësejt **214** objekte te reja, kurse modifikimi i te dhenave te prone eshte kryer ne **2.449** raste.
- **Ankesat** - gjatë afatit të parashtrimit të ankesave, nga muaji janar deri me 31 maj 2022 janë pranuar gjithësejt **19 Ankesa** nga tatimpaguesit. Prej tyre 7 Ankesa jane parashtruar kunder Fatures se tatimit ne prone dhe 12 Kerkresa per korigjim te parcelave. Ankesat pas verifikimit ne teren, jane shqyrtuar dhe vendosur nga ana e Komisionit per verifikim. Nga gjithesejt 19 Ankesa, te gjitha jane Aprovuar .
- Ne afatin e parapare ligjor te gjitha ankesa te aprovuara jane procedu ne sistemin e tatimit ne prone. Per te gjitha rastet e ankesave, jane punuar Vendimet me shkrim.
- **Vertetimet** – Çdo dite punohet me pale dhe sipas kerkeses se tyre ne gjashtemujorin e pare te ketij viti jane leshuar nga sistemi i tatimit ne prone gjithesejt **3.460** Vertetime. Vertetimet nga sistemi kryesisht leshohen per nevoja personale , transfer prone, per aplikime ne sektorin e bujqesise etj.
- **Planifikimi dhe realizimi-** Per vitin 2022 ne emer te te Hyrave Vetanake Komunale nga Tatimi ne Prone jane planifikuar te inkasohen gjithesejt **397.000,00 €**.

Per periudhen raportuese, realizimi mujor dhe ne total eshte si ne tabelen e meposhtme:

REALIZIMI PER VITIN 2022 / PLANIFIKIM 397.000,00 €

MUAJI - 2022	REALIZIMI
Janar	12.686,69
Shkurt	17.491,68
Mars	67.011,74
Prill	42.906,78
Maj	54.473,10
Qershor	19.519,70
Gjithsejt	214.089,69 €

Realizimi per periudhen raportuese , respektivisht deri me **daten 30.06.2022** jane inkasuar **214.090,06 € ose 54 %** nga shuma e planifikuar .

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

RAPORTI GJASHTË MUJOR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR, 2022

Hyrje

Ky raport pasqyron aktivitetet, angazhimet dhe punët e kryera nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim (ne tekstin e mëtutjeshëm - DEZH), gjatë periudhës Janar - Qershor 2022.

Objektivi kryesor i DEZH për vitin 2022, është ngritja e ndikimit të tij në realizimin e projekteve të filluara dhe planifikimin e investimeve në projektet e reja, si dhe kryerja e punëve tjera varësisht nga detyrat dhe obligimet e stafit të kësaj Drejtorie. Gjatë periudhës së raportimit stafi i kësaj Drejtorie është në proces të kryerjes së punëve të filluara ne vitin 2021 në mënyrë që të ndikoj që ky sektor të jetë sa më eficient. Në vijim, do të jepet raporti vjetor i punës për çdo sektor dhe zyre, që vepron në kuadër të DEZH.

Qëllimi

Njoftimi i anëtarëve te Komitetit për Politikë e Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe te gjithë drejtorët e drejtorive me realizimin e investimeve te planifikuara, zhvillimin, shpenzimet dhe rezultatin e arritur në raport me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit. Përmes këtyre raporteve sigurohen informacione te rëndësishme relevante për opinionin publik në lidhje me performancën fiskale, rezultatet e programeve, rrjedhën e parasë së gatshme etj.

1. Sektori për ekonomi

Gjatë kësaj periudhe personeli i sektorit të ekonomisë është angazhuar në kryerjen e këtyre punëve dhe detyrave si:

Organizim dhe koordinimi i punëve të sektorit për ekonomi, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë.

- Përgatitja e listës së borgjeve për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrje hoteliere , të paraparë me Rregulloren Komunale 2/2021.
- Përgatitja e aktvendimeve për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike në bazë të Rregullores Komunale 2/2021.
- Angazhimi, në sistemin e ARBK(Agjensioni për Regjistrim Biznesit Kosovë) për regjistrimin e bizneseve, ndryshime dhe shuarje të bizneseve.
- Përcjellja e aktivitetit ekonomik të bizneseve, mbledhja e shënimeve për aktivitetin e tyre ,ndihma e dhëne dhe informimi rreth regjistrimit, shuarjes dhe ndryshimeve në biznes .
- Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare ,si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, gjegjësisht Sektorit për Ekonomi.

Në Qendrën Komunale të Bizneseve janë kryer këto punë:

Regjistrim i bizneseve--81.

Shuarje të bizneseve ---8.

Ndryshime në biznes-----44.

Informatat e biznesit ,Certifikata Logo e re, Certifikata Duplikat ----82.

Vërtetim biznesi----- 04.

Këshillime për regjistrim të bizneseve- 126

Këshillime për ndryshime ne biznes ---- 134

Këshillime për shuarje të biznesit----- 32

Duhet te theksohet se me një vendim të MTI-së se regjistrimi i bizneseve behet pa pagesë(taksa),ndërsa taksat tjera ende aplikohen (për ndryshime pagesë (taksa)), ndërsa taksat tjera ende aplikohen(për ndryshime ne biznes për shtim aktiviteteve, ndërrimin e logos etj.)

-Përcjellja e aktivitetit ekonomik në nivel komunal dhe qendror.

-Përcjellja e aktivitetit të bizneseve, vizita e këtyre bizneseve, mbledhja e shënimeve për aktivitetin e tyre ,ndihma e dhëne dhe informimi rreth regjistrimit dhe regjistrimit të tyre.

-Mbledhja, përpunimi I shënimeve dhe dërgimi I tyre për Ministrinë plotësimi I formularëve, pyetësorëve me shënimet e kërkuara, broshurave etj.) ..

-Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare ,si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtoratit për Ekonomi Zhvillim, gjegjësisht QKB -së

2. Sektori i zhvillimit

Sektori për zhvillim në vazhdimësi është duke bërë identifikimin e projekteve prioritare për propozime, si dhe po merr pjesë në aktivitetet rreth zhvillimeve rajonale, kontaktet dhe takimet me donatorët potencial. Takimet e rregullta janë mbajtur me AZHR-në dhe Ministrinë për Zhvillim Rajonal lidhur me njoftimet për fondet që planifikohen të ndahen si grante për projekte, si dhe po realizohen punëtori javore në identifikimin e pikave strategjike për zhvillimin potencial të turizmit në të gjitha komunat e rajonit.

Takime te vazhdueshme po realizohen edhe me OJQ_të tjera. Në bashkëpunim me organizatën Preda Plus Socio Projekti dhe ASB-në janë mbajtur trajnimet për ngritje te kapaciteteve me grupin e grave te Komunës se Istogut, ku edhe është bere ndarja e granteve për 8 start-up biznese te cilat do te udhëhiqen nga gratë.

Përveç tjerash, sektori për zhvillim është angazhuar edhe në komisionet për vlerësimet e ofertave të projekteve kapitale.

Tabela e projekteve kapitale të cilat janë në procedurë e sipër për periudhën Janar - Qershor 2022

		Grante	THV	Totali	Gjendja
1	Asfaltimi i Rrugve lokale ne Saradran	50,000		50,000	Në procedurë
2	Ndërtimi i rrugëve në Gurakoc	30,000		30,000	Nuk ka filluar
3	Ndërtimi i rrugëve në Vrellë	30,000		30,000	Nuk ka filluar
4	Ndërtimi i Rrugëve ne Banje	40,000		40,000	Në procedurë
5	Ndërtimi i rrugëve lokale ne Kaliqan:Ukaj, Metaj	20,000		20,000	Në procedurë
6	Ndërtimi i rrugëve "Xheme Avdylaj"&"Selim Brahimi" ne Shushice	30,000		30,000	Në procedurë
7	Ndërtimi i rrugës "Selim Brahima" Shushicë	13,000		13,000	Projekti ka përfunduar
8	Ndërtimi i rrugëve "Fushë Kuqe"dhe "Molla e Kuqe" në Kovragë	30,000		30,000	Në procedurë
9	Asfaltimi i rrugës Regjë Kastrati ne Kashice	25,000		25,000	Në procedurë
10					

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI
RAPORTI GJASHTË MUJOR PËR PERIUDHËN 01.01.2022-30.06.2022

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Kadastrës, Pronës dhe Gjeodezisë është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori për Gjeodezi;
2. Sektori për Kadastrë;
3. Sektori për Prona;

Gjatë kësaj kohe të raportimit, në këta sektorë, zyrtarët janë ngarkuar në kryerjen e punëve sipas përshkrimit të vendeve të punës.

Më poshtë kemi paraqitur të dhënat statistikore në formë tabelare rreth kërkesave të parashtruara dhe lëndëve si në vijim:

Lënda	Totali i kërkesave	Kërkesa të aprovuara	Kërkesa të refuzuara	Kërkesa në procedurë
Ndarje Fizike	4	4	0	0
Shitblerje	206	168	2	36
Dhurim	108	89	0	19
Këmbim	5	5	0	0
Në bazë të pranimit	5	3	0	2
Trashëgimi	90	65	1	24
Vërtetim Pronësie	10	9	0	1
Aktgjykim	1	1	0	0
Ndërtimit/kompensim	2	2	0	0
Bartje e qiramarrjes	7	5	0	2
Bashkim parcelave	38	32	3	3
Korrigjim	4	3	1	0
Fshirje e Hipotekës	33	28	2	3
Fshirje e Barrës Tatimore	3	3	0	0
Kopje të Planit	1031	1031	0	0
Modifikim i attributeve	71	65	3	3
Ndarje e parcelave	99	90	1	8
Regjistrim i hapsirave të përbashkëta	2	2	0	0
Regjistrim i hipotekës	20	18	1	1
Regjistrim i ndërtesës	29	22	0	7
Regjistrim i barrës tatimore	4	3	0	1
Regjistrim i pjesëve të ndërtesës	16	13	2	1
Masë sigurie	6	6	0	0
Çertifikata Pronësie	2176	2176	0	0
Dalje në teren sipas kërkesave zyrtare	36	33	0	3
Historiat	41	26	5	10

Sa i përket dhënies së pronave në shfrytëzim nga Komuna, më datë 31.03.2022, është votuar nga asambleja komunale lista e veqantë e pronave për dhënie në shfrytëzim ndërsa me datë 29.06.2022, janë formuar komisioni vlerësues për dhënie të pronave në shfrytëzim si dhe komisioni i ankesave.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS

RAPORTI GJASHTË MUJOR JANAR - QERSHOR 2022

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mjedis, gjatë vitit 2022, kujdes i veçantë i është kushtuar përfundimit të lëndëve të vjetra për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë, duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim ende pa arritur zgjidhjet urbane, andaj është aprovuar zgjidhje urbane që do t'u ndihmojë kërkuessve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë II.

Gjatë këtij gjashtë mujori janë përfunduar lëndët e vjetra me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Për më tepër, vonesa paraqesin procedurat për legjitimimin e marrëveshjeve të ndryshme pronësore si bashkimi i parcelave ose shpronësimi, si dhe ndërrimi i destinimit të tokës, duke mos lënë anash edhe vonesat e palëve për të marrë informimet për plotësim dokumentacioni.

Sfidë për DPUM është edhe implementimi i projekteve që i përkasin Drejtorisë sonë. Janë në zotuar mjetet për projektin "Rregullimi i shtratit të lumit Istog prej 150.000,00 € dhe projekte tjera me një buxhet prej 70.000,00 € të listuara më poshtë:

Sektori i urbanizmit

Gjatë kësaj peridhe janar – qershor të vitit 2022, është evidentuar numër i caktuar i kërkesave për shkak të Pandemisë dhe Krizës globale, andaj dhe intensiteti i punës në sektor ka treguar një kujdes në zgjidhje të lëndëve. Janë evidentuar mbi 155 kërkesa, prej të cilave 53 kërkesa për kushte dhe leje ndërtimi. Janë trajtuar 53 kërkesa nga 55 sa janë pranuar PËR Kushte dhe Leje ndërtimore. Janë miratuar 43 leje ndërtimi, nga të cilat 1 ndërtesë e banimit shumëkatëshe i është vazhduar LN dhe 33 ndërtesa të banimit individual. Gjithashtu 7 ndërtesa për zhvillim ekonomik dhe 3 ndërtesa tregtare-afariste janë procesuar dhe janë pajisur me Leje ndërtimore. Sikur edhe është paraqitur në tabelë, gjatë këtij viti janë përcaktuar kushte-pëlqime ndërtimi për 105 kërkesa, derisa 95 kërkesa janë përfunduar me pëlqime të ndryshme, pëlqime parimore paraprake sa i përket pronës dhe të ngjashme. Janë në procesim edhe 10 kërkesa.

Koha	Leje ndërtimi	Kushte ndërtimi	Certifikatë përdorimi	Pëlqime për ndërtim	Pëlqimet	Përgjigje (refuzuara)
Janar	2	1	1	26	32	47
Shkurt	8	3				
Mars	11	4				

Prill	9	0	2			
Maj	4	0				
Qershor	9	2				
Gjithsej	43	10	3	26	32	47

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01/22.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej 24.200,00 €, nga taksa administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, si dhe nga taksa administrative për leje të rrënimit.

Gjithashtu janë realizuar 1.620,00 € nga taksa për pajisjen me certifikatë pelqime dhe shërbime tjera në kuadër të DPUM. Gjithsej, drejtoria ka realizuar 25.820,00 € euro.

Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit (Permit tracking System), ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit, duke përfshirë sugjerimet e ekspertit nga projekti i USAID-it, të cilat informata janë përgatitur në formë postierësh dhe do të publikohen në vende të dukshme për informimin sa më të mirë të qytetarëve me procedurat dhe dokumentet e nevojshme për pajisje me leje ndërtimi. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim.

Një ndër punët më me rëndësi është dhe emërtimi i rrugëve, i udhëhequr nga Sektori i shërbimeve të përbashkëta, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv.

Duhet theksuar se këtë vit është krijuar dhe Zyra për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DUNMM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

- ☐ Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;
- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema

në zgjidhje;

- ☐ Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;
- ☐ Përpunimi i faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- ☐ Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
- ☐ Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
- ☐ Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve
- ☐ Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
- ☐ Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
- ☐ Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
- ☐ Takimet me qytetarët për diskutimet për Hartën Zonale
- ☐ Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
- ☐ Përgatitja e detyrave projektuese;
- ☐ Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
- ☐ Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- ☐ Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
- ☐ Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
- ☐ Pranimi i lëndëve dedikuar vetëm për Sektorin e legalizimit;
- ☐ Fillimi i trajtimit të lëndëve të legalizimit;
- ☐ Hartimi i databazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- ☐ Fushata informuese dhe sensibilizuese;
- ☐ Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
- ☐ Legalizimi i objekteve të para;
- ☐ Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
- ☐ Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
- ☐ Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
- ☐ Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
- ☐ Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
- ☐ Mbjellja e drurëve dekorativë;
- ☐ Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPHI;
- ☐ Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2022, ka qenë Memorandumi i bashkëpunimit të Agjensionit kadastral për mirëmbajtje të adresave dhe vendosja e shenjave të komunikacionit dhe emërtimin e rrugëve publike në komunën e Istogut.
- ☐ Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të

nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

Legalizimi

- Është siguruar numri i zyrtarëve profesionist, sfidat që presin ekipin tonë të zyrtarëve janë të mëdha dhe së kërkon staf të përgatitur mirë në aspektin profesional;
- Trajnimi i stafit sipas konditave dhe standardeve më të reja, të cilat do të aplikohen në përdorimin e programit të caktuar dhe të avancuar për aplikim trajtim, të kërkesave në trajtim të ndërtimeve pa leje, në bashkëpunim me MMPHI-në dhe Memorandumi i programit mbështetës të USAID-it.

Aktivitetet e planifikuara:

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për ndërtimet pa leje, të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, ndërtimet pa leje të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, dhe ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Caktim të kushteve ndërtimore për dhënien e Lejes për legalizim dhe përfundim të ndërtimit, të kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra në takimet e mbajtura sinë aspektin e eliminimit dhe procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e kohës së nevojshme për përfundimin e atij procesi;
- Riorganizimi e punës në Zyrën shërbyese, One Stop Shop, e cila duhet të funksionon në kuadër të Sektorit të urbanizmit dhe legalizimit të kësaj drejtorie;

Mjedisi

Gjatë periudhës janar-qershor 2022 nga Sektori për Mbrojtje të mjedisit janë realizuar këto detyra:

- Gjatë këtij gjashte mujori janë parashtruar 7 kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale ,
- Janë lëshuar 7 Vendime për LMK të shoqëruar me 7 procesverbale të hartuara në teren . Një kërkesë për LMK nga viti paraprak është kthyer përgjigjeje me konkluzion .
- Zhvillimi me sukses i Aksionit e Duam Istogun e Pastër , takimi më nxënës për ngritjen e Kapaciteteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit si dhe manifestimi për pastrim e ambientit me rastin e ditës së Tokës 22 Prillit.
- Në kuadër të detyrës nga Drejtoria për Inspektion , Inspektori i mjedisit janë parashtruar 6 kërkesa- ankesa të ndryshme që kemi hartuar 6 proces verbale .
- Njehe rit kem i qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, angazhime dhe Punëtori të Ekipeve Komunale AZHR –Perëndim

- Bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor .
- Shuma e përgjithshme e taksës të paguar për Leje Mjedisore Komunale për gjashtë mujorin e vitit 2022 është 4584 Euro.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

RAPORT I PUNËS :GJASHTË MUJOR 2022

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional nr.02 L-42,Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve nr. 02/L-24, Ligjin për Arsimin Parashkollor nga MASHT, dhe UA të MASHTT-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunës për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale.

Ministrja e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit, Në mbështetje të nenit 5 paragrafit 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011),nenit 8, paragrafit 1, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV(MASHTI) NR. 7 / 2021 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2021/2022

Viti shkollor 2021/2022, ka filluar me 1 shtator 2021 dhe do të përfundojë me 31 gusht 2022.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor-mësimor 2021/22 të përfundojë sipas normave të përcaktuara në këto vendime dhe udhëzime,

Viti mësimor,ka filluar me 27 shtator(shtyrje për shkak të virusit Corona),dhe ka përfunduar :

- -Klasët e 12-ta me 19 maj 2022,
- -klasët e 9-ta ,10-ta dhe 11-ta,me 10 qershor 2022,
- -klasët e parafillores dhe nga 1-8-ta, më 24 qershor 2022.kurse
- -Institucionet e kopshteve do ta përfundojnë më 29 korrik 2022.

Organizimi i punës është udhëhequr dhe menaxhuar nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me aktorët tjerë si MASHTI dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit parauniversitar si dhe udhëzimet e lartëcekura.

Zhvillimi profesional i mësimeve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASH-it, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimeve.

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me drejtorët e shkollave dhe akteret tjerë institucional lokal dhe qendror ,ka organizuar dhe monitoruar procesin mësimor, testin e arritshmërisë dhe testin e maturës ,

Këto organizime dhe monitorime janë bërë në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet, strategjitë dhe protokollet e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim.

Në përfundim të vitin shkollor 2021/22 numri i nxënësve që ju ka nënshtruar :

- Testin e arritshmërisë është 527 nxënës, kurse
- Testin e maturës 416 nxënës.
- Në klasën e parë deri në kohën e raportimit janë regjistruar 522 nxënës.
- Në klasë e 10-të në Gjimnazin Haxhi Zeka të regjistruar Sipas Kriterve deri në kohën e raportimit janë: 108 nxënës në dy drejtime, kurse
- Në SHMT Mithat Frasheri janë regjistruar 105 nxënës në 5 drejtime.
- Për regjistrim në shkollat e mesme është edhe afati i dytë 3 ditë i cili fillon me 22 gusht.

Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me shkollat është e angazhuar në procesin e parandalimit braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkollë.

Ne kemi analizuar nevojat dhe ju kemi përgjigjur kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kjo ka qenë kompetencë e ekipit komunal për vlerësim pedagogjik i cili ju është përgjigjur çdo kërkesë që është iniciuar duke vlerësuar dhe analizuar çështjet me rekomandime për kompetentët.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar me organizimin i trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në mësimdhënie dhe në të nxënës.

Spektori administrativ për periudhën , Janar –Qershor ka arritur të realizoj këto aktiviteteve si më të rëndësishme:

- Pranimi dhe shqyrtimi dhe vendosja me mbi 250 lëndëve të natyrave të ndryshme që e karakterizojnë drejtorin e arsimit.
- Janë lëshuar 15 vendime për pushim të lehonisë
- Janë lëshuar 15 vendime për pensionim të stafit arsimor

- Shpalljen e disa konkurseve për pranim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 30 kontrata të punës për mësimdhënës dhe punëtor teknik të të gjitha niveleve të cilët janë pranuar sipas procedurave të rregullta ligjore.
- Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave Komunale
- Shpallja e konkursit për regjistrim të nxënësve për klasat e 10 në shkollat e mesme të larta të Komunës së Istogut.
- Shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.
- Shqyrtimi i ankesave të drejtuara këtij drejtorati nga natyrat të ndryshme

Projektet kapitale

Drejtoria Komunale e Arsimit ka pregaditur të gjitha dokumentet dhe ka derguar në zyre të prokurimit për procedurën e tenderimit. Këto projekte :

- -Rekuizita për kopshte të fëmijëve
- -Furnizimi i shkollave me rrjetë të internetit,
- -Material për mirëmbajtjen e shkollave,
- -Mirëmbajtja e kamerave në institucionet shkollore,
- -Transporti i nxënësve fshat-shkollë,
- -Ndërimi i kalldasë SHMT “Mithat Frasheri” -Gurakoc,
- -Ndertimi i kalldasë sh.f. “Zymer Zeka” -Kaliqan,
- -Ndërimi i dyerve në Gjimnazin “Haxhi Zeka” -Istog
- -Instalimi i kamerave në 2 objekte të reja shkollore (Uçë dhe Llukavc), si dhe në Qerdhen e re në Vrellë,
- -Sigurimi i nxënësve në praktikën profesionale,
- -Renovimi i qerdhes në Rakosh, dhe
- -Digjitalizimi i klasave në Institucionet shkollore.

Në këtë gjashtë muor të këtij viti kanë përfunduar edhe 2 projekte që kanë qenë të pa përfunduara dhe atë:

- „Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe” në Uçë, dhe
- “Fan S. Noli” në Llukac të Begut ,

Të dy këto shkolla si dhe Qerdhja e Re e fëmijëve në Vrellë –pas inventarizimit pritet të futen në funksion në këtë vit shkollos 2022/2023.

Shpenzimi i Buxhetit në Drejtorinë Komunale të Arsimit, për periudhën Janar-Qershor 2022, për kategorinë mallra dhe shërbime dhe Komunal, është:

	Mallra dhe Sherbime	Komunali
DKA-ja	24 941.42(kryesisht shpenzime transporti nga viti i kaluar dhe tani)	
Arssimi parafillor-qerdhet	11 999.15 (kryesisht ushqim)	3913.10
Arsimi Fillor	19 625.34 (material zyre dhe shpenzime interneti)	10 933.92
Arsimi i mesëm	12 750.79 (material zyre, shpenzime interneti,lëndë djegëse-dru)	4 281,00
Totali:	69 316.70 €	19 128.02€

Në kuadër të Drejtorit të Arsimit është Komisioni i formuar nga Zyra e Kryetarit që së bashku me Expert të jashtëm është në Përfundim të

- Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit për periudhën 2022-2026.si dhe
- Draft rregullorës për Ndryshim dhe Plotësimin të rregullorës për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës. ,si dhe
- Shkollat së bashku me organet drejtues të mbrendshme dhe DKA-ja janë në përfundim të Hartimit të Rregullores së mbrendshme për shkolla

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS, JANAR-QERSHOR, 2022

Rezultatet e arritura ne periudhën janar-qershor 2022, Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sporti gjate kësaj periudhe ka zhvilluar një varg aktivitete kulturore dhe sportive. Këto aktivitete janë organizuar në nivele të shkollave,nivel lokal dhe në nivelin komunal e shtetëror ne te gjitha degët e sportit .

Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit veçohen këto aktivitete:

Kanë përfunduar	Në proces	Ngecje

Nga gjithsej 69 kërkesa , 34 janë miratuar, 7 janë refuzuar, 28 janë në procesë (kërkesa të cilat pritet tu jepet vendim pas vlerësimit të komisionit për thirrje publike si dhe për qendër rinore.	Projekti I vetëm kapital për vitin 2022- Ndërtimi i Qendrës Rinore në Uçë(kanë përfunduar procedurat e tenderimit me sukses)- nga java e ardhshme fillojnë punimet atje.	Hapja e konkurseve për dy pozitat e lira në DKRS përkundër kërkesës së vazhdueshme për stafë shtesë hapja e konkurseve ende nuk ka ndodhur.
Aktivitetet- Aktiviteti për ditën ndërkombëtare për Sinrom Doën 22 Mars Aktivitet në bashkëpunim me KOK- 'Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe' 06.04.2022 Koncerti i parë I Muzikës Klasike 11.06.2022 Aktivitet Kulturor për 20 qershor ditën e çlirimit.	Thirrja publike për subvencionim të OJQve në kuadër të Kulturës, Rinisë dhe Sportit(thirrje gjithsej 40.000 euro) ka përfunduar gjithsej janë 20 aplikacione jemi në pritje të themelimit të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve. Me vendim të Kryetarit është themeluar komisioni për vlerësimin e dhënjes në shfrytëzim të zyreve ne Shtëpinë e Kulturës në të cilin është bërë procecverbal dhe pritet së shpejti dhënja në shfrytëzim me kritere në bazë të rregullores së Komunës. Jemi në procedurë të licencimit të qendrës rinore e cila do hap mundësi për aktivizimin e të rinjëve.	Hapja e konkuresit për drejtor të Shtëpisë së Kulturës ende ska ndodhur përkundër kërkesës. Vazhdimi i punimeve në projektin për sallën sportive në Vrellë.

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE HIDROEKONOMI

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS, JANAR-QERSHOR, 2022

Sektori i Bujqësisë:

Aktivitetet në periudhën janar- qershor/2022

Komuna e Istogut përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është e orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë me efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Bujqësia dhe pylltaria janë sektorët kryesorë të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Duke u bazuar në plan programin e punës në kuadër të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

1. Aktivitetet në periudhën, janar- qershor 2022

Ne kuadër të DBPH-së-së nga muaji janar janë realizuar një mori aktivitete. Ndër me kryesorët do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ne muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndet e vitit paraprak , ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtarja kompetente e arkivës komunale
- Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 4 zyrtar të rinj me kontrata për shërbime të veçanta ,përmes ligjit të prokurimit, të cilët janë trajnuar dhe të përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte
- Janë iniciuar procedurat e prokurimit për projektet kapitale dhe zotimi i mjeteve
- Pranim dhe përgjigje në kërkesa të palëve
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si; vërtetime për fermer, vlerësimi i dëmeve të ndryshme , etj

2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre

2.1 Kërkesat drejtuar sektorit të bujqësisë

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 67 kërkesa të ndryshme të palëve, në sektorin e bujqësisë.

Pranuar	Ne proces	Miratuara	Ceduara	Refuzuara	Hedhur poshtë
67	5	29	3	25	1

- Gjatë fazës së aplikimit të fermerëve për pagesa direkte janë pranuar dhe proceduar 1212 aplikacione të specifikuara si më poshtë:

Nr.	Sektori		Viti 2022	Sipërfaqja/ha	Nr. I aplikacioneve
1	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2.338,54	404
		Grurë kg			
		Grurë për farë		59.39	1
		Misër		1.749,6	456
		Thekër		14.25	6
		Elb		46.16	28
		Tërshërë		54.25	29
		Lule dielli		2.05	1
2	Perime kulturë	Perime në fushë		115.58	86
		Perime në sera		1.17	4
		Fasule monokulturë		5.63	2
		Kunguj misri		10.13	8
		Vreshta		10.68	2
3	Pemëtari	Pemë		324.26	180
		Pemë të imta		4.81	7
		Material fidanor		65.200	1
4	Blegtori	Lopë qumështore		4.299 krerë	449
		Qumësht litra		/	/

		Bletë		8.028 koshere	127
		Dele		7.701 krerë	76
		Dhi		1.341 krerë	16
		Viça për majmëri		/	/
		Dosa		11	3
5	Shpeztari	Pula		30.500	3
		Peshk		/	/
6	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		44.62	18
7	Bujqësi organike	Organike		109.38	5

Totali i lëndëve të trajtuara ; 1212 copë +63 copë = 1275 kërkesa

3. Projektet kapitale

Janë zotuar mjetet dhe kanë filluar procedurat e prokurorimit dhe janë në fazën e përzgjedhjes operatorët ekonomik për implementimin e projektit

- Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot 1 dhe Lot 2
- Betonimi i kanalit të Trubuhocit

Është iniciuar procedura për projektin

- Kullimi i tokave bujqësore dhe
- Betonimi i kanalit Osmanaj-Drejë

Në fazën finale të përfundimit të punimeve ndodhen edhe dy projekte

- Betonimi i kanalit të Lubeniqeve dhe
- Betonimi i kanalit në lagjen Balaj –Lluga

Projekt i përfunduar

- Ndërtimi i " Kroit në Lugu i Butë "

4. Sektori i pylltarisë

1. Aktivitete për periudhën janar- dhjetor / 2022

- Është vazhduar me aktivitete të rregullta sipas planifikimeve vjetore, angazhim në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, florës dhe faunës
- Me vendim të Kryetarit të komunës në muajin maj janë bërë regjistrimet e përgjithshme të demit pyjor

- Është bërë shejimi i masës drunore së bashku me zyrën rajonale të APK-së , për shitje të rregullt dhe për furnizim të qytetarëve
- Është bërë lëshimi i lejeve për prerje në pyje private, damkimi dhe dhënja e fletë përcjelljeve

